



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 51/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për apelin e subjektit politik Partia Social Demokrate (PSD) të përfaqësuar nga Kaqusha Jashari, paraqitur kundër vendimit me nr. 533/2014 të dt. 21.03.2014 të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), në seancën e panelit të mbajtur me 06.05.2014, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i subjektit politik Partia Social Demokrate (PSD)

Arsyetim

PZAP-i me datën 05.05.2014 ka pranuar një apel nga Kaqusha Jashari përfaqësues i subjektit politik PSD paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me nr. 533/2014 të dt. 21.03.2014 për shkak të shqiptimit të gjobës për dorëzimin me vonesë të raportit financiar të fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale të 3 Nëntor 2013. Parashtruesi i apelit thekson se ata kanë dorëzuar raportin në fjalë mirëpo vonesat rreth dorëzimit të saj kanë ndodhur për disa arsye pasi që sipas tyre ata nuk kanë qenë të informuar sa duhet për domësdoshmërin e paraqitjes së raportit dhe se shuma e cila është shpenzuar për fushatë ka qenë një shumë simbolike dhe duke menduar se mjafton që këto shpenzime të raportohen në raportin vjetor. Parashtruesi i apelit më tutje thekson se përshkak të lëvizjes së disa kuadrove të tyre dhe kalimi i tyre në subjekte tjera politike kanë ndikuar që disa nga përgjegjësitë për këto çështje nuk janë paraqitur fare dhe të cilat kanë pasur ndikim në këto vonesa dhe se subjekti në fjalë përballet me vështirësi financiare pasi që nga koalicioni i përbashkët që e kishin ju është mohuar e drejta e financimit nga buxheti gjë e cila edhe sipas parashtruesit të apelit ja ka vështirësuar dhe ja ka reduktuar aktivitetet e tyre politike. Andaj me këtë rast parashtruesi i apelit thekson se nuk ka pasur shkelje të qëllimshme pasi që pas sqarimit të situatës me KQZ-në menjëherë është përgatitur dhe është dorëzuar raporti në fjalë.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në më datën 05.05.2014, për apelin që është bërë ndaj vendimit të saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj apelit në fjalë deri më datë 06.05.2014 në ora 10:00. PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ-ja në të cilën theksohet se me datën 27.09.2013 KQZ-ja përmes postës elektronike i ka informuar subjektet e ndryshme politike, me këtë rast edhe subjektin politik PSD që brenda afatit ligjor pra deri me datën 18.12.2013 të dorëzoj raportin e shpenzimeve financiare të fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale të 3 Nëntor 2013, ku me këtë rast subjekti politik PSD e ka dorëzuar raportin në fjalë në vonesë prej shatëdhjet e një (71) ditëve. Andaj sipas KQZ-së vendimi i saj në shqiptimin e gjobës për vonesë në dorëzimin e raportit në

fjalë është i bazuar në nenin 21.1 të ligjit për financimin e subjekteve politike, nenit 4 të rregullës zgjedhore 12/2013 dhe nenit 1.4 të rregullës zgjedhore 14/2013.

PZAP-i, pas administrimit të pretendimeve ankimore, vendimit kontestues të datës 21.03.2014 me numër të protokollit 533-2014 të KQZ-së, përgjigjen në apel të KQZ-së gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka rikualifikuar si apel duke i bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

Neni 40.1 (Kërkesat për Deklarim Financiar) të LZP-së, përcakton se: *çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, dorëzon Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit, duke i përfshirë të gjitha degët dhe pjesët përbërëse të tij, për periudhën që fillon nëntëdhjetë (90) ditë para zgjedhjeve dhe me mbarim në ditën e zgjedhjeve. Raporti i Publikimit Financiar për Fushatën dorëzohet jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve.*

Neni 42.1 (Sanksionet) të LZP-së përcakton se *KQZ-ja mund ta ngarkoj subjektin politik i cili e bënë Publikimin e Raportit Financiar pas afatit përfundimtar, me pagesa administrative në pajtim me rregullat.*

Në këtë kontekst, subjekti politik (PSD), ka qenë i detyruar në bazë të këtij ligji që të dërgoj Raportin Financiar për fushatën zgjedhore jo më vonë se 18 Dhjetor 2013 – gjë që nuk ka ndodhur, prandaj mbi këtë bazë pretendimet ankimore janë të pabazuara pasi që subjekti politik PSD ka vepruar në kundërshtim më nenin 40 paragrafi 1 të LZP-së, për shkak të mosdorëzimit të raportit financiar të periudhës së fushatës zgjedhore ashtu siç kërkohet më dispozitën e lartcekur, por e ka dorëzuar me vonesë prej shatëdhjet e një (71), ditëve nga data kur ka qenë e obliguar ta bëjë dorëzimin e saj. Andaj, bazuar nga arsyet e theksuar më lart dhe bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP, në të cilin parashihet se: *PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet*, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 51/2014 më datën 06.05.2014.



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*